

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), neni 53 paragrafi (4) nënparagrafi 3 dhe paragrafi 5, dhe në lidhje me paragrafët 6 dhe 19 nga neni i njëjtë të Ligjit në fjalë, pika 4 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark. nr.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-5538/1 datë 23.12.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-174/3 datë 14.1.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 1-rë të mbajtur më 14.1.2026, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) MODEA SHPKNJP Sveti Nikollë, për shkeljen e kryer të nenit 53 paragrafi (4) nënparagrafi 3 dhe paragrafi 5, dhe në lidhje me paragrafët (6) dhe (19) nga neni i njëjtë të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrë që në shërbimin programor në radio të transmetuesit, emetuar më 3 dhjetor 2025, në katër blloqe reklamuese është transmetuar komunikim komercial audio në të cilat është paraqitur në mënyrë të rreme natyra dhe karakteristikat e shërbimit reklamues ku është nxitur sjellje e dëmshme për shëndetin.

Shkelja e përmendur në paragrafin 1 të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-5538/1, datë 23.12.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR MODEA SHPKNJP Sveti Nikollë menjëherë pas pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit me dispozitat e Ligjit të cituar, lejet, certifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është

kryer shkelje ose cënimi i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (4) nënparagrafi 3 të LSHMAAV, komunikimet komerciale audiovizuale nuk duhet të nxisin sjellje që është e dëmshme për shëndetin ose sigurinë. Ndalohen komunikimet komerciale audiovizuale që përfaqësojnë në mënyrë të rreme natyrën, karakteristikat, cilësinë ose origjinën gjeografike të produkteve, shërbimeve ose veprimtari komerciale (neni 53 paragrafi 5 të LSHMAAV).

Neni 53 paragrafi (6) të LSHMAAV përcakton se për përgjegjësinë dhe vërtetësinë e gjetjeve dhe të dhënave në komunikimet komerciale audiovizuale është përgjegjës porositësi i tyre, dhe për harmonizim me ligjin redaktori përgjegjës (kryeredaktori) i ofruesit të shërbimit mediatik audiovizuel. Dispozitat e këtij neni në mënyrë adekuate zbatohen dhe për komunikimet komerciale audio (neni 53 paragrafi 19 të LSHMAAV).

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 22 dhjetor 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor në radio të SHTR MODEA SHPKNJP Sveti Nikollë të transmetuar më 3 dhjetor 2025, në nivel lokal (në zonën e komunës Sveti Nikollë), ku konstatoi shkelje të nenit 53 paragrafi (4) nënparagrafi 3 dhe paragrafi (5), dhe në lidhje me paragrafët (6) dhe (19) nga neni i njëjtë i LSHMAAV, sepse në disa raste, transmetoi komunikim komercial audio në të cilën natyra dhe karakteristikat e shërbimit të reklamuar u paraqitën në mënyrë të rreme dhe në këtë mënyrë nxitën sjellje të dëmshme për shëndetin. Konkretisht, nga mbikëqyrja u konstatua se SHTR MODEA SHPKNJP Sveti Nikollë, në katër blloqe reklamuese, transmetoi komunikim komercial audio/njoftim reklamues me përmbajtjen e mëposhtme: - *"Unë trajtoj (shërojmë) baktere, cista, urinim natën, gurë në veshka, ankth, trauma, shtyllë kurrizore, spondilozë, kancer, bronkit, diabet, keqkuptime në martesë dhe depresion. Trajtojmë (shërojmë) në distancë, në Viber - informacion në telefon 077 900 325"* (e specifikuar në detaje sipas datës, titullit të emisionit, periudhës së transmetimit (me fillim dhe mbarim) dhe përshkrim të shkeljes në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr. 10-5538/1 datë 23.12.2025).

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtua SHTR MODEA SHPKNJP Sveti Nikollë, më 25.12.2025, dërgoi Shkresë me nr ynë.ark.10-5538/2 datë 25.12.2025, me të cilën paraqiti Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-5538/1 datë 23.12.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoj deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 30.12.2025. Në afatin e parashikuara, përkatësisht më 31.12.2025, SHTR MODEA SHPKNJP Sveti Nikollë drejtuar Agjencisë dorëzoj Deklaratë me shkrim nr ynë.ark.10-5538/3 datë 31.12.2025. Këshilli i Agjencia në seancën e mbajtur më 14.1.2026, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim nga transmetuesi dhe konkludoi që ndaj SHTR MODEA SHPKNJP Sveti Nikollë të shqiptohet masë – paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LShMAAV, neni 53 paragrafi (4) nënparagrafi 3 dhe paragrafi 5, dhe në lidhje me paragrafët (6) dhe (19) nga Ligji i njëjtë, pika 4 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-5538/1 datë 23.12.2025 dhe Konkluzionin ark.nr. 02-174/3 datë 14.1.2026, për shkak të mosrespektimit të konstatuar të dispozitave të LSHMAAV të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 1-rë të mbajtur më 14.1.2026, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR MODEA SHPKNJP Sveti Nikollë, dhe urdhërohet që menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-5538/1 datë 23.12.2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.